



## KOMUNIKATË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), njofton subjektet politike të cilat nuk i kanë të paguara gjobat e shqiptuara nga zgjedhjet e kaluara nga Komisioni i Zgjedhjeve për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP), nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), si dhe nga Zyra për Regjistrimin e Partive Politike (ZRPP), se afati i fundit për t'i paguar gjobat është 15 shtatori 2009.

Bazuar në nenin 15.12 të Ligjit nr. 03/073 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, dhe nenit 2.3 të Rregulles 08/2009 mbi Certifikimin e Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre, KQZ konfirmon se do të pezullojë procesin e aplikimit për certifikim të subjektit politik që nuk i përmbahet kërkesës së shlyrjes së gjobave.

Pagesa për gjobat e shqiptuara nga KZAP-it mund të bëhen në xhirollogarinë e KZAP-it.

*Emri i bankes: Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës*

*Adresa e bankes: Rr. Garibaldi 33, Prishtinë*

*Emri i xhirollogarisë: Pagesa kryesore, Llogaria e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave*

*Numri i xhirollogarisë: 10004000700000180*

Kurse pagesa për gjobat e shqiptuara nga KQZ-ja dhe ZRPP-ja bëhet në xhirollogarinë e KQZ-së: 1000430070004398

Për informacione të më tutjeshme kontaktoni ZRPP-në: 038. 551 - 697